REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 453/26 Dt. 23.09.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58, shkronja f, dhe nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), dhe nenit 50 shkronja (i), 51 dhe 63 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË SHËNDETËSISË

1. Mybera Mustafa, emërohet në pozitën e drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit.

2. Mandati i drejtoreshës do të fillon nga data 23 shtator 2026 dhe do të jetë i njëjtë me mandatin e kryetarit të Komunës. Emërimi i bërë me këtë vendim mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga ana e kryetarit të Komunës në pajtim me dispozitat e ligjit dhe akteve tjera nënligjore.

3. Detyrat dhe përgjegjësit e drejtoreshës së Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008 dhe udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës si dhe në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

4. E emëruara do ti raportoj rregullisht kryetarit të Komunës për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që e udhëheqë.

5. Obligohet e emëruara, Kabineti i Kryetarit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtoria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Kabinetit të Kryetarit të Komunës,
- Të emëruarës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Arkivës së Kryetarit.